



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

Nr. 5, datë 27.02.2020

**PËR**

**MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TE NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË , PËR MUAJIN SHKURT 2020.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike“, VKB nr.2, datë 29.01.2020 "Për miratimin e kritereve, për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”, VKB nr.647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe Projekt-Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022” sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z. Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI:**

1. Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës, 86 familje me një fond 290.900 lekë.
2. Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar, 6 familje me një fond 13.860 lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

3. Heqjen nga Skema e Ndhmës Ekonomike, për këtë muaj gjithsej 3 familje nga fondi i Bashkisë për arsyet e mëposhtme :

**A. Njësia Administrative Nr 2**

- Elmir Gjyshi Mungesë dokumentacioni .
- Lutfi Cepeli Mungesë dokumentacioni .

**B. Njësia Administrative Sukth**

- Namik Kurti Mungesë dokumentacioni .

4. Mos miratimin në listën e skemës së ndihmës ekonomike të 0 familjeve, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligjin Nr.57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin Këshillit Bashkiak Durrës Nr.2, datë 29.01.2020 "Për miratimin e kriterëve, për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”.

5. Për muajin Shkurt 2020, futjen në skemën e ndihmës ekonomike të 3 familjeve, të cilat janë familje në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond të veçantë nga Bashkia Durrës.

- Xhemal Tare Familje në nevojë
- Burbuqe Fida Familje në nevojë
- Nik Vatnikaj Familje në nevojë

6. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia 0 familje.

7. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar 0 familje.

8. Për muajin Shkurt 2020, të jenë përfitues të ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar 6 familje :

- Gladiola Muci Familje në nevojë
- Bajame Zylfa Familje në nevojë
- Teuta Drizati Familje në nevojë
- Bujar Buna Familje në nevojë
- Flutura Herri Familje në nevojë
- Vjollca Jora Familje në nevojë

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social në varësi të Bashkisë Durrës.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 28.02.2020**